



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - КОСОВСКА РЕПУБЛИКА			
KOMUNA E VITISË - ОПШТИНА ВИТИНА			
Progr./Prenje/Prillog		30-06-2022	
Nr./Shprehje/Opisje	Numri/Šifra	Emri/Ime	Vlera/Šifra
01-110/05-658			

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Vitina

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2023

Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi Komunal i Vitisë MIRATON vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.

Komisioni përbëhet nga këta anëtar:

1. Bekim Azizi Kryesuesi i Kuvendit Komunal
2. Valentina Mehmeti, GP- të LDK-së
3. Jakup Demiri Shefi i GP- të VV-së
4. Vilsona Maliqi-Salihu, GP- të PDK-së
5. Reshat Azizi Këshilltar komunal nga AAK-së
6. Fatlum Demiri Sekretaria e Kuvendit
7. Milihate Osmani Përfaqësues nga shoqëria civile

Neni 2

Grupi punues, konform nenit 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2023 dhe të njëjtin e paraqet para kuvendit të komunës për miratim.

Neni 3

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të kuvendit dhe komiteteve obligative dhe funksionale të kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara, si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.

Neni 4

Plani i punës së kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të grupit punues; dhe
3. Arkivit.

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi

